



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 17, Datë 06.02.2024

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 1” SH.P.K. PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT TË ERE-S PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SAJ SI KOLATERAL
PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 8, 9, pika 8 dhe 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.02.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 54/2 prot., datë 01.02.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. për vendosjen e kutoave të saj si kolateral për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.05.2023.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2532 prot., datë 18.12.2023, ajo ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si kolateral për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj palës kredi dhënëse (Banka e Parë e Investimeve - Albania sh.a dhe First Investment Bank AD, Sofie Bullgari).
- Pas shqyrtimit të dokumentacionit, me shkresën nr. 54 prot., datë 08.01.2024, ERE i ka evidentuar shoqërisë informacion/dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.
- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE nr. 54/1 prot., datë 18.01.2024, ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pikat 1 dhe 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.
- Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa i përket pagesave rregullatore.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9, pikës 8 të Rregullores, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj.
- Referuar kontratës nr. 110 Rep., nr. 31 kol., datë 13.01.2023, nënshkruar midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 20 MW dhe veprave ndihmëse, nga shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k.”, konstatohet se vlera e kredisë është më e lartë se vlera e investimit e përcaktuar në kontratë, shoqëria ka sqaruar se investitorit do t’i levrohet shuma e kredisë sipas faturave të marra nga furnitorët dhe nuk është i detyruar që të përdorë të gjithë shumën e kredisëpor nëse do të konstatohet ndodhja e ngjarjeve që shkaktojnë këto rritje në vlerën e investimit, shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. do të vijojë me përmbushjen e detyrimeve sa i takon ndryshimeve përkatëse të domosdoshme në vlerën e investimit në kontratën e nënshkruar me MIE-n.
- Për sa argumentuar nga shoqëria, vlerësohet që në vendimin e dhënies së autorizimit të vendoset një klauzolë, që në rast se në zbatimin e kontratës së kredisë bankare, për garantimin e detyrimeve të së cilës po kërkohet dhe vendosja e kuotave si kolateral, do të preket ndonjë nga përcaktimet e kontratës nr. 110 Rep., nr. 31 kol., datë 13.01.2023, ky autorizim bëhet nul.
- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi kuotat për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë ERE-n për shlyerjen e plotë të detyrimit dhe heqjen e këtij kolaterali, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Erseka Solar Park” sh.p.k. si mjet (kolateral) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve të saj ndaj për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj palës kredidhënëse (Banka e Parë e Investimeve - Albania sh.a dhe First Investment Bank AD, Sofie Bullgari).

2. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
3. Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj.
4. Në rast se në zbatimin e kontratës së kredisë bankare, do të preket ndonjë nga përcaktimet e kontratës nr. 110 Rep., nr. 31 kol., datë 13.01.2023, nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi bëhet nul.
5. Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të detyrimit dhe heqjes së barrës siguruese mbi kuotat e saj, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.
6. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
7. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI